



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 226/1 Prot.

Tiranë, më 7 / 2 / 2018

V E N D I M

Nr. 53, Datë 7 / 2 / 2018

Mbështetur në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 28, datë 11.05.2017, e L.S<sup>1</sup>, përfaqësuar nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara kundër Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë Qytet dhe Drejtorisë së shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “Aftësisë së kufizuar” të djalit së saj të diagnostikuar me Autizëm fëmënor.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

Sipas shpjegimeve të dhëna, L.S informon se: “Djali i saj që prej muajit Nëntor 2016 është nxënësi në shkollën “Shyqyri Peza”. Komisioni i vlerësimit të shkollës caktoi që ..... të ndjekë klasën e pestë duke arsyetuar vendimin me faktin se djali ishte 12 vjeç dhe i zhvilluar fizikisht. Prindi e ka konsideruar të papërshtatshëm këtë vlerësim dhe ka kërkuar caktimin e një mësuesi ndihmës, duke iu drejtuar me shkresë në datë 20.12.2016 Drejtorisë Arsimore Rajonale Tiranë, por që nuk ka marrë përgjigje. Nëna e fëmijës me aq sa ka patur mundësi është munduar të integrojë ..... në mësim, por nuk ka patur asnjë rezultat pasi mungon plani PEI, asistencë e duhur profesionale dhe caktimi në një klasë të përshtatshme. Ankuesja shpreh shqetësimin që djali i saj i diagnostifikuar me Autizëm është i diskriminuar në krahasim me nxënësit e tjerë të klasës për shkak se shkolla dhe DAR Tiranë nuk kanë marrë asnjë masë për të vlerësuar saktë nevojat e fëmijës, për të përgatitur programin edukativo-individual (PEI) si dhe të caktoj një mësues ndihmës”.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri, ndalimin e diskriminimit të nxënësit ..... dhe marrjen e masave të nevojshme nga ana e DAR Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare “Sh.Peza”, lidhur me caktimin e një mësuesi ndihmës, sipas përcaktimeve në Udhëzimin Nr. 38, datë 07.10.2014

<sup>1</sup> Në cilësinë e prindit të fëmijës D.S

“Kriteret e mësuesit ndihmës dhe për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

Diskriminimi për shkak të aftësisë së kufizuar është një nga shkaqet e mbrojtura nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, në nenin 3/1, parashikohet se “Diskriminim’ është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasoje pengesën apo bërjen të pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi”.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit Nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga subjekti ankues, L.S, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

**Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:**

- Me shkresën Nr. 435/1, datë 19.05.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Drejtoria Arsimore Rajonale Tiranë dhe Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Sh.Peza”, Tiranë, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga znj. L.S.
- Me shkresën nr.435/2, datë 21.06.2017 janë rikujtuar dhe njëherë subjektet: DAR Tiranë dhe shkolla “Sh.Peza” në lidhje me detyrimin që kanë për të kthyer përgjigje.

Me shkresën nr. 36, datë 31.05.2017 të administruar nga Komisioneri me nr.435/2, datë 21.06.2017, Drejtoria e Shkollës 9-vjeçare “Sh. Peza”, në mes të tjerash informon se: *“Plani PEI është hartuar në periudhën Janar-Shkurt 2017, muaj në të cilët nxënësi ka filluar të paraqitet në shkollë. Plani është hartuar në bashkëpunim të ngushtë mes psikologes së shkollës, mësueses kujdestare dhe nënës së fëmijës. Prindi i fëmijës ka refuzuar të firmosë planin edukativ me pretendimin se D.S mund të realizojë objektivat mësimorë dhe sjellorë të përcaktuara aty dhe si rrjedhojë do të kalojë në klasë të VI. Drejtoria e shkollës me shkresën datë 23.11.2016 i është drejtuar me kërkesë DAR-it Tiranë për mësues ndihmës, por nxënësi ka nisur frekuentimin e rregullt të shkollës, vetëm në muajin Janar 2017. Drejtoria e shkollës thekson faktin se, plani edukativ për fëmijën është hartuar në bashkëpunim me prindin e nxënësit, edhe pse L.S ka refuzuar të firmosë, sepse pohon se nëse djali i saj bën progres të mirë në shkollë, mund të kalojë në klasë të VI-të. Vlerësimet psikologjike bazuar në vëzhgimet në klasë dhe bisedat me mësuesen dhe prindin tregojnë se fëmija ka rezultate të prekshme dhe të dukshme, falë punës së individualizuar të mësueses, ndjekjes së planit PEI dhe mbështetjes së pakushtëzuar të nxënëseve të klasës dhe së fundi, caktimi në klasën e V-të është bërë për hir të moshës së fëmijës dhe*

*sjelljeve të tij agresive, të cilat do të rrezikonin mirëqënien e nxënësve më të vegjël, të cilët nuk do të mbroheshin dot”.*

Me shkresën nr.435/4, datë 04.07.2017, L.S ka informuar Komisionerin, duke deklaruar se: *“Ka patur shumë vështirësi për rregjistrimin e fëmijës në shkollë për shkak se D.S ishte me aftësi të kufizuara dhe shkolla nuk pranonte, duke u shprehur se nuk kishte mësues ndihmës. Pas vlerësimit që është bërë nga drejtuesit e shkollës, u caktua që D.S të ndiqte klasën e pestë, me kusht që vetëm pasi në shkollë të kishte një mësues mbështetës. Në këto kushte, pavarësisht se fëmija ishte regjistruar në shkollë, ai nuk mund ta ndiqte atë, pasi nuk kishte mësues mbështetës. Më pas, L.S është vënë në dijeni që Komisioni i DAR, kishte vajtur në shkollë, por edhe pse shkolla kishte kontaktet e saj për ta lajmëruar atë ditë ose dhe më vonë, nuk mori asnjë masë për tu interesuar për të bërë një vlerësim të nevojave të fëmijës. Programi PEI për nxënësin, është përgatitur pasi L.S ka paraqitur ankesën tek Komisioneri dhe më pas i është kërkuar që ta firmosë, por në asnjë moment nuk është konsultuar për këtë program. L.S informon se djali i saj nuk ka libra të përshtatur për aftësitë e tij si nxënës i klasës së pestë”.*

Mbështetur në nenin 33, pika 8, të ligjit nr. 10221/2010 "Për Mbrojtjen nga Diskriminimi", për shqyrtimin e mëtejshëm të çështjes, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vendosi të realizojë një seancë dëgjimore mes palëve e cila nuk u realizua në datë 26.07.2017 për arsye se Drejtori i shkollës "Sh. Peza" ishte larguar me pushime vjetore. Në këto kushte, seanca dëgjimore nuk u zhvillua dhe u shty për në datë 07.09.2017.

Në datë 07.09.2017 në mjediset e zyrës së Komisionerit u zhvillua seanca dëgjimore. Gjatë zhvillimit të seancës, drejtori i shkollës, ...B deklaroi se: *“Që në takimin e parë me prindin e fëmijës, i është kërkuar që të bënte kërkesë pranë DAR-it për mësues ndihmës. Drejtori i ka kërkuar prindit të fëmijës që nëse do të ketë mësues ndihmës, nxënësi mund të frekuentojë shkollën, por duke qenë se nuk kishte mësues ndihmës është rënë dakord me prindin, që nxënësi të frekuentonte shkollën në praninë e prindit ose pasi të caktohej mësuesi ndihmës”.*

Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore, ...J<sup>2</sup> deklaroi se: *“Vlerësimi i nxënësve me aftësi të kufizuara nga ana e DAR-it zhvillohet në fillim të muajit Tetor dhe pastaj sa herë që ka kërkesa, Komisioni shkon në çdo shkollë. Si procedurë, Komisioni i DAR-it komunikon me shkollën për të caktuar kohën kur do bëhet vlerësimi i nxënësve me AK dhe pastaj shkolla komunikon me prindërit dhe nxënësit për të bërë vlerësimin”.*

Me shkresën nr.714/2, datë 08.09.2017 i është kërkuar informacion shtesë DAR-it Tiranë në lidhje me vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara të shkollës "Sh.Peza".

Me shkresën nr. 3206/1, datë 16.10.2017 DAR Tiranë ka dërguar pranë Komisionerit dokumentacionin e kërkuar në lidhje me procedurën e ndjekur për vlerësimin e nxënësve me aftësi të kufizuara të shkollës "Sh.Peza".

<sup>2</sup> Anëtare e Komisionit Multidisiplinar të DAR Tiranë.

Me shkresën nr.255, datë 22.12.2017, Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara ka informuar se, për vitin shkollor 2017-2018, fëmija D.S është rregjistruar në shkollën 9-vjeçare “Betim Muço”, Kombinat.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

### **Bazuar në faktet e mësipërme dhe në analizë të legjislacionit në fuqi, Komisioneri vlerëson:**

Legjislacioni shqiptar në fushën e arsimit i jep përparësi të dukshme, trajtimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara, në institucionet arsimore shqiptare.

- E drejta për arsimim është një e drejtë kushtetuese, e përcaktuar në nenin 57 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e cila po ashtu gëzon një mbrojtje të posaçme nga Konventa e OKB-së “Për të drejtat e PAK”.
- Sipas nenit 116 të Kushtetutës, Konventa, si një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj, në hierarkinë e normave juridike renditet menjëherë pas Kushtetutës. Për pasojë, ajo zë një vend të rëndësishëm në të drejtën e brendshme e bëhet e detyrueshme për t’u zbatuar për çdo shtet, për të gjithë organet shtetërore.
- “*Konventa e OKB-së për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara*” e ratifikuar nga Shqipëria me ligji nr. 108/2012, datë 15 Nëntor 2012, i ofron mbrojtje personave me aftësi të kufizuar, duke ndryshuar para së gjithash, trajtimin e aftësisë së kufizuar nga ai bazuar në modelin mjekësor, në trajtimin sipas modelit social. Konventa ka për qëllim të nxisë, të mbrojë dhe t’u sigurojë që të gjithë personat me aftësi të kufizuar të gëzojnë plotësisht dhe në mënyrë të barabartë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të nxisë respektin për dinjitetin e tyre. Parimi i mosdiskriminimit është një ndër parimet e kësaj Konvente, ku ofrohet një *mbrojtje e veçantë për fëmijët me aftësi të kufizuar*, për të siguruar *që këto fëmijë të gëzojnë të gjitha të drejtat dhe liritë themelore të njeriut njësoj si të gjithë fëmijët e tjerë*.

Në këtë kuadër, legjislacioni shqiptar u ngarkon detyra të rëndësishme njërive arsimore vendore (DAR/ZA) dhe drejtuesve të institucioneve arsimore, lidhur me mënyrën, se si duhen asistuar dhe krijuar kushtet e nevojshme dhe të përshtatshme në mësimdhënie për nxënësit me aftësi të kufizuara. Qëllimi kryesor i këtij legjislacioni në tërësinë e tij, është krijimi i të gjithë kushteve të nevojshme, që këta fëmijë të mund të arsimohen njëloj si të gjithë fëmijët e tjerë, si dhe ajo që vlen të theksohet më tepër është prioriteti i këtij legjislacioni për t’i përfshirë dhe integruar ata në institucionet arsimore të zakonshme.

Nën këtë frymë konsiston edhe përmbajtja e nenit 63, pika 2 e ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet: “*Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në institucionet arsimore të specializuara për ta është përgjithësisht e*

*përkohshme. Përfshirja dhe integrimi i fëmijëve me aftësi të kufizuara në kopshtet dhe shkollat e zakonshme të arsimit bazë është parësore”.*

Në Urdhrin nr. 343, datë 19.8.2013, i Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, në nenin 95/1 parashikon shprehimisht se: “Drejtori i institucionit arsimor të zakonshëm ngrre komisionin për nxënësit me AK, në përbërje të të cilit janë tre mësues të lëndëve të fushave të ndryshme të të nxënës dhe psikologu/punonjësi social.

Në nenin 96, pika 2, germa b) të Urdhrit të sipërpërmendur parashikohet si detyrë e drejtuesit të institucionit arsimor të zakonshëm të nxisë përmirësimin e jetës së nxënësve me AK në mjediset e institucionit arsimor. Dispozita e mësipërme përcakton shprehimisht se, Drejtuesi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim.

**Nga sa rezultoi gjatë shqyrtimit të ankesës, drejtorja e shkollës 9-vjeçare “Sh.Peza”, Tiranë nuk ka marrë masat për vlerësimin e nevojave dhe të hartimit të planit PEI për nxënësit D.S, menjëherë sapo nxënësi është paraqitur dhe regjistruar në shkollë<sup>3</sup>, pasi referuar procesverbalit të seancës dëgjimore datë 07.09.2017, nuk ka një vendim të komisionit të shkollës për vlerësimin e nevojave për nxënësin D.S, si dhe hartimi i planit PEI nga ana e shkollës, është realizuar në periudhën Shkurt 2017, pa miratimin e prindit.**

Drejtori i shkollës “Sh.Peza”, në cilësinë e personit përgjegjës për inicimin e procedurave të vlerësimit të nevojave arsimore dhe shoqërore, për nxënësit me aftësi të kufizuara, nisur nga parimi i interesit më të lartë të fëmijës, duhet të kishte marrë masat me karakter pozitiv për ti ardhur menjëherë në ndihmë fëmijës dhe prindit në drejtim të krijimit të kushteve për ndjekjen e shkollës dhe jo të krijonte pengesa me arsyen se fëmija të ndjekë shkollën kur të caktohet mësuesi ndihmës.

Përsa i përket aftësisë së kufizuar të nxënësit D.S, bazuar në dokumentacionin<sup>4</sup> e depozituar pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, rezulton që vuan nga sëmundja Autizëm Fëminor.

Megjithatë, për të përcaktuar saktësisht, nëse një fëmijë me aftësi të kufizuar, duhet të ndjekë një institucion arsimor të specializuar apo një shkollë të zakonshme të arsimit bazë, legjislacioni parashikon:

1. Në nenin 64, pika 3 i ligjit të sipërpërmendur dhe nenit 93, të Urdhërit nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave, parashikohet që: Si detyrim ligjor të

<sup>3</sup> Nxënësi D.S është paraqitur në shkollë në datë 10.12.2016.

<sup>4</sup> Vendimi i Komisionit Mjekësor të Caktimit të Aftësisë për Punë Nr. 3132, datë 12.07.2016 dhe dosja personale e nxënësit e plotësuar nga psikologja e shkollës E.M.

njesisë arsimore vendore apo DAR-it, të krijojë një komision, të përbërë nga mjekë, psikologë, mësues dhe specialistë për fëmijët me aftësi të kufizuara, i cili, pasi shqyrton kërkesën e prindit ose të drejtorit të një institucioni arsimor, jep rekomandimet përkatëse për ndjekjen nga fëmija të një institucioni arsimor të zakonshëm a të specializuar.

Nga sa rezultoi gjatë trajtimit të rastit, drejtuesi i shkollës 9-vjeçare “Sh.Peza”, Tiranë pas insistimit të prindit të nxënësit D.S, në datë 23.12.2016 ka paraqitur një kërkesë formale me shkrim pranë DAR Tiranë, në të cilën ka kërkuar mësues ndihmës për nxënësin D.S. Drejtoria Arsimore Rajonale, Tiranë me shkresën nr.5691/1, datë 25.01.2017 në mes të tjerash ka njoftuar prindin e fëmijës D.S se Komisioni Psikosocial ka shkuar në shkollë për të bërë vlerësimin e fëmijës por nxënësi nuk ka qenë në shkollë, si rezultat i mosfrekuentimit të shkollës nga D.S. Në lidhje me këtë, Komisioni psikosocial i DAR Tiranë dhe drejtuesi i shkollës “Sh.Peza” duhet të kishte marrë masat për lajmërimin në kohë të L.S, në mënyrë që komisioni të vlerësonte nevojat e nxënësit për mësues ndihmës. Pavarësisht mos vlerësimit të nevojave të nxënësit D.S, në periudhën Janar 2017, përsëri Komisioni psikosocial i DAR Tiranë, duke vënë interesin më të lartë për fëmijën, në periudhën në vazhdim, duhet të kishte marrë masat për të bërë vlerësimin e nevojave të nxënësit, pasi ishte vënë në dijeni se nxënësi D.S ishte regjistruar në shkollë.

Në lidhje me sa më sipër, nga ana e DAR Tiranë nuk u vendos në dispozicion të Komisionerit ndonjë dokument që të vërtetonte se Komisioni psikosocial i DAR Tiranë, të kishte njoftuar shkollën dhe prindin për vlerësimin e nevojave të nxënësit D.S në periudhën Janar 2017 apo dhe në periudhën në vijim deri në përfundim të vitit shkollor.

Bazuar në nenin 93, të Urdhrit nr. 343, datë 19.08.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave, DAR Tiranë ka detyrime të rëndësishme, lidhur me asistencën dhe kujdesin ndaj nxënësve me aftësi të kufizuara që mësojnë në institucionet arsimore të qytetit të Tiranës.

Ky nen parashikon në mes të tjerash se: “Ngritja e komisionit pranë DAR/ZA-së dhe detyra të tij:

3. *Komisioni, me kërkesën e prindit të fëmijës ose të drejtorit të institucionit arsimor, ku fëmija është regjistruar, vlerëson nevojat arsimore e shoqërore të fëmijës dhe ecurinë e tij. Komisioni mbledhet 3 herë në vit, para fillimit të vitit shkollor, në fund të semestrit të parë dhe në fund të vitit mësimor.*
6. *Komisioni:*
  - a) *njofton prindin për gjendjen dhe ecurinë e fëmijës;*
  - b) *i jep me shkrim personit që ka paraqitur kërkesën, rekomandimin për ndjekjen nga fëmija të shkollës së zakonshme ose të specializuar ose kalimin nga shkolla e specializuar në shkollën e zakonshme apo anasjellas;*
  - c) *sugjeron kopshtin/shkollën me kushtet më të përshtatshme për nxënësin;*
  - d) *rekomandon shërbimet shtesë që duhet të marrë fëmija në qendra ditore ose në institucione të tjera të specializuara për shërbimet rehabilituese;*

e) rekomandon pajisjen e fëmijës me raportin mjeko-ligjor, kur fëmija nuk e ka.

8. Komisioni fton të paktën një prind gjatë vlerësimit të fëmijës dhe po të jetë e nevojshme, të afërm të tij. Kur fëmija është në kopsht/shkollë, përveç prindit marrin pjesë: punonjësi i shërbimit psiko-social në institucionin arsimor, mësues të fëmijës të caktuar nga drejtori i institucionit arsimor.

13. DAR/ZA-ja siguron kushtet e përshtatshme për ushtrimin e punës së komisionit.

Nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, gjykojmë se nxënësi D.S, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë nga sa parashikohet në DN<sup>5</sup> dhe ligjin për Arsimin Parauniversitar, përmes mos përfitimit të asistimit me mësues ndihmës në procesin e të nxënës në procesin mësimor dhe argumentet e dhëna nga Drejtorja e Shkollës “Sh. Peza” dhe DAR Tiranë vërtetojnë faktet e pretenduara nga ankuesja se shkolla nuk ka dashur të pranojë nxënësin në klasë pa patur një mësues ndihmës.

Kjo ka bërë që nxënësi D.S, të mos marrë shërbimin që duhet ti ofrohet sipas parashikimeve të DN dhe të cenohet në të drejtën e tij për një trajtim sa më dinjitoz, me qëllim integrimin dhe ofrimin e arsimit në përputhje me standardet që kërkojnë aktet ndërkombëtare dhe legjislacioni shqiptar në fuqi.

Këtë frymë kanë ruajtur dhe Ligji 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe Dispozitat Normative për Sistemin Arsimor Parauniversitar 2013, ku përcaktohen qartë detyrimet e të gjitha strukturave për të garantuar të drejtën e fëmijëve me aftësi të kufizuara për t’u arsimuar dhe për të garantuar një arsim gjithëpërfshirës.

### **PËR KËTO ARSYE :**

Mbështetur në nenin 1, 2, 7, 19, 32, pika 1, germa c), nenin 33, pika 10, të Ligjit nr.10 221,datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nenit 63, pika 2, neni 64, pika 3, neni 65, pikat 2-3, të Ligjit nr. Nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, si dhe neneve 93-96 të Urdhrit nr. 343, datë 19.8.2013, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencave “Për miratimin e dispozitave normative për sistemin arsimor parauniversitar”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

### **V E N D O S I :**

1. Konstatimin e diskriminimit të nxënësit D.S, për shkak të aftësisë së kufizuar, nga ana e Drejtorisë Arsimore Rajonale, Tiranë Qytet dhe Shkollës 9-vjeçare “Shyqyri Peza”, përmes mos përfitimit të asistimit me mësues ndihmës në procesin e të nxënës në procesin mësimor.

<sup>5</sup> Shkurtesë për Dispozitat Normative të arsimit parauniversitar.

2. Marrjen e masave të menjëhershme nga ana e DAR Tiranë Qytet, që nxënësit D.S ti caktohet një mësues ndihmës sipas vlerësimit të Komisionit Psikosocial.
3. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, DAR Tiranë Qytet, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e këtij vendimi.
4. Në referim të nenit 33, pika 11, të ligjit nr. 10 221, datë 04. 02. 2011, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, moszbatimi i këtij vendimi sjell si pasojë ndëshkimin me gjobë sipas parashikimeve të bëra në pikën 13 të po këtij neni.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi në gjykatë, brenda afateve ligjore.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

(shkaku: aftësia e kufizuar)

(fusha: arsim)